



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA POGRADEC  
KËSHILLI

**Procesverbal**

**Konsultim publik :**

**Data :** 23/01/2025      **Ora :** 10:00

**Vendi:** Fshati Guras

**Numri i pjesëmarrësve :** Gjithësej 15 persona të pranishëm (2 gra), (13 burra)

**Titulli i Projekt-aktit që konsultohet :**

“ Për një ndryshim në vendimin Nr.85, datë 19.10.2021 “ Për miratimin e orareve dhe stacioneve në linjën rrethqytetëse Guras – Pogradec - Guras”.

**Pjesëmarrës :**

Nexhat Shtupa ( Specialist )

Jani Cinari ( Kryeplaku I fshatit Guras)

Florenc Gora (Administrator I Njesisë Bucimas)

Vjollca Pllaha (Këshilltare)

Suela Mertkola (Punonjwse sekretariati)

Z.Cinari: Ju falenderoj për pjesëmarrjen tuaj, jemi mbledhur sot për dëgjesën publike për oraret e linjës Guras – Pogradec – Guras. Kërkesa është bërë nga Administratori Z. Florant Cake. Po ja jap fjalën përfaqësuesit të Bashkisë Z. Shtupa për të shpjeguar projekt – vendimin.

Z. Shtupa: Ju falenderoj për pjesëmarrjen tuaj, në bazë të kërkesës që i është drejtuar Bashkisë ne kemi erdhur për të dëgjuar edhe mendimin tuaj për oraret që do të ndryshohen në këtë linjë, jeni të lirë të jepni mendimin tuaj.

Banor i fshatit Guras: Ne nuk kemi ndonjë kundërshtim,duhet të shihni vetëm gjatë periudhës së verës që oraret të jenë më të shpeshta.

Z.Cinari: Do ju lutesha të keni parasysh vetëm oraret e mëngjesit mos lëvizin sepse në orën 6:30 duhet të jenë në punë gratë që punojnë në rrobaqepsi. Kemi edhe nxënësit edhe infermieret që marin turnin në mëngjes.

Z.Shtupa: Nuk kemi probleme me oraret e mëngjesit, ato do të ngelen ashtu sic janë, problemi qëndron tek oraret e mbasdites, ku gjatë periudhës së dimrit nuk ka lëvizje.

Z.Cake: Unë sygjeroh që të hiqen oraret e mëngjesit sepse nuk ka lëvizje, oraret janë 06:30 , 07:00 ku nisja bëhet nga Gurasi dhe për mbasditen oraret 18:00, 18:30, 19:00. Të hiqen edhe oraret ku nisja bëhet nga Pogradeci në 6:30, 07:30, 17:30, 19:00, 19:30. Ky është sygjერი im.

Z.Cinari: Do të kemi probleme gjatë periudhës së verës.

Banor i fshatit Guras: Për ne është shumë mirë, vetëm në kohën e verës të zgjaten oraret.

Z.Shtupa: Ne mund të bëjmë një shënim përkatës ku të thuhet që ora 17:00 nga Gurasi edhe ora 18:00 nga Pogradeci të jenë për periudhën 01 Qershor deri 31 Gusht.

Z.Cake: Mund tju bëj një pyetje? A e dini ju sa paguaj unë në muaj taksë tek Terminali, jo nuk e dini. Paguaj 600 mijë lek në muaj. Për oraret që nuk janë të nevojshme pse ti mbajmë, unë jam dakort si ju të vendosni, ju them me siguri këto orare që unë sugjeroj nuk prishin punë.

Z.Cinari: Jam dakort le të vendoset me shënim.

Banor i fshatit Guras: Edhe ne jemi dakort oraret janë shumë të përshtashme.

Z.Cinari: Mund të marim edhe një mendim nga infermieret.

Infermieret: Nuk na prishin punë jemi dakort për oraret që ju keni vendosur.Z.Gora: Përshëndetje! Për sa kohë jemi të gjithë dakort e mbyllim këtu dëgjuesën publike, Ju falenderoj për pjesëmarrjen tuaj.

Mbajti procesverbalin: Suela Mertkola

Sekretare e Këshillit  
Jona Bojko

